



18 mars 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA Statusi i Planeve Rregulluese Urbane të Komunës së Prishtinës

Projekti i monitorimit të transparencës së drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës synon ngritjen e nivelit të transparencës lokale në vendimmarrje përmes monitorimit të ekzekutivit të komunave dhe raportimin për praktikën e vendimmarrjes lokale. Pjesë e projektit do të jetë edhe asistencë teknike për vendosjen e rendit urbanistik në Prishtinë.

Objektivat specifikë të projektit "Transparenca Online në komunën e Prishtinës" përfshijnë: ngritjen e nivelit të informimit publik mbi vendim-marrjen lokale; inicimin e mekanizmave qeveritare dhe gjyqësore për adresimin e keqpërdorimeve (shkelja e ligjeve dhe procedurave); rritjen e nivelit të transparencës në vendimmarrjen lokale; rritjen e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në lidhje me ligjshmërinë në qeverisjen vendore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendim-marrje lokale.

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës, EC Ma Ndryshe gjatë muajve të parë të këtij viti ka hulumtuar dhe analizuar statusin e planeve rregulluese dhe vendimet e kuvendit komunal në lidhje me hartimin dhe miratimin e planeve rregulluese prej vitit 1999 deri më sot.

Bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike (03/L-215), në fillim të janarit, Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, OJQ EC Ma Ndryshe i ka kërkuar qasje në të gjitha vendimet dhe planet rregulluese dhe planet detaje të lagjeve të Prishtinës të cilat vazhdojnë të jenë në fuqi. Pasqyra e mëposhtme është e bazuar vetëm në materialin që na është dhënë nga kjo drejtori si përgjigje në kërkesën tonë.

Në bazë të Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor (Ligji Nr. 04/L-174) Neni 17 pika 8: *Komuna shqyrton dhe sipas nevojës e ndryshon Planin Rregullues të Hollësishëm çdo pesë (5) vite.* (Me Ligjin e ri për Planifikim Hapësinor, ndryshe nga ligji paraprak kur komunat hartonin plane rregulluese urbane, tash e tutje komunat duhet të hartojnë plane rregulluese të hollësishme). Bazuar në këtë ligj, nga materiali që kemi marrë nga komuna në lidhje me planet rregulluese del se, nga gjithsejt 21 plane rregulluese të miratuara nga Kuvendi Komunal nga viti 2005 deri në vitin 2013, 8 nga to u ka skaduar afati i rishikimit të fundit.

Sipas komunës së Prishtinës, rishikimi i disa nga këto plane është pezulluar përkohësisht për të shkak të nevojës së hartimit të planeve rregulluese të hollësishme bazuar në Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor të Republikës së Kosovës.

Nga hulumtimi, u konstatua edhe numri i madh i planeve detaje për lagje të Prishtinës (planeve të hartuara në vitet e '70 dhe '80 të shekullit të kaluar) të cilat janë ende në fuqi. Nga vendimet e marra nga kuvendi komunal, shihet se për disa nga to ekzistojnë vendimet për nisjen e hartimit të tyre, por procedurat nuk janë çuar deri në fund dhe si pasojë nuk ka as vendim miratimi të planit e as plan rregullues. Një nga këto lagje që ka në fuqi plan detaj të vitit 1978 dhe për të cilin ekziston një vendim i vitit 2006 për fillim hartim të planit rregullues është ajo e zonës Qyteti i Vjetër, zonë kjo e cila ka pësuar mjaft keq nga kaosi urbanistik dhe degradimi i saj përkeqësohet dita ditës. Plani rregullativ i kësaj zone është inicuar (me procedurat e tenderimit) tri herë rradhazi nga Komuna e Prishtinës dhe është ndërprerë për shkak të kërkesës për përpilimin paraprak të Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Dhe në fund, disa fjalë për transparencën e dokumenteve publike të kësaj drejtorie. Gjatë hulumtimit tonë hasëm se jo të gjitha planet rregulluese, që janë dokumente publike janë lehtë të qasshme për qytetarët. Mungon një numër i madh i tyre në ueb faqen zyrtare, ose janë të pjesshme dhe jo mirë të organizuara.

Për këto arsye EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prishtinës që:

- Pas nxjerrjes së rregulloreve të reja nga ligji për Planifikim Hapësinor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të nis rishqyrtimin e menjëhershëm e planeve rregulluese të skaduara,
- Pas nxjerrjes së rregulloreve të reja nga ligji për Planifikim Hapësinor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të nis procedurat e rishikimit/ hartimit të planeve të reja për lagjet e Prishtinës në të cilat janë në fuqi planet detaje urbanistike që nga vitet '70 dhe '80 të shekullit të kaluar,
- Të rris transparencën e dokumenteve publike – planeve rregulluese dhe detaje në fuqi, duke i publikuar të gjitha në ueb faqen e komunës.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit të komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.



British Embassy
Prishtina

TABELA E PLANEVE RREGULLUESE URBANISTIKE, PLANEVE DETAJE URBANISTIKE NË FUQI DHE E VENDIMEVE MBI PLANIFIKIM HAPËSINOR TË KOMUNËS SË PRISHTINËS*

Nr.	Lagjet e Prishtines	PRRU **	Data e miratimit e propozim planit	Data e vendimit të fillimit të hartimit të PRRU-së	Datat e miratimit të PRRU-së	Data e fillimit të ndryshimit/ plotësimit të PRRU-së	Datat e miratimit të plotësimit/ ndryshimit të PRRU-së	Data e skadimit e rishikimit të fundit të PRRU-së	Statusi
1	Arbëria 1	JO		23.07.2009	/	/	/		Ekziston plani detaj urbanistik. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2009, por nuk ka miratim te planit rregullues urbanistik.
2	Arbëria 2	JO		23.07.2009	/	/	/		Ekziston plani detaj urbanistik. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2009, por nuk ka miratim te planit rregullues urbanistik.
3	Arbëria 3	PO	19.08.2005	/	22.11.2005	12.07.2012	24.07.2007 03.04.2008	03.04.2013	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar.
4	Dardania	PO		/	05.06.2009		/		Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
5	Dodona	PO	21.06.2005	/	03.08.2005		/	03.08.2010	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar.
7	Kalabria	PO	21.06.2005	/	03.08.2005	27.05.2011	/	03.08.2010	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar.
8	Kodra e Diellit	JO							Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1976. Nuk është marrë vendim për rishikim/ hartim të planit.
9	Kodra e Diellit 2	JO							Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1985. Nuk është marrë vendim për rishikim/ hartim të planit rregullues.
10	Kodra e Trimave 1	JO		16.07.2008	/		/	/	Ekziston plani detaj urbanistik. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2008, por nuk ka miratim te planit rregullues urbanistik.
11	Kodra e Trimave 2	JO		16.07.2008	/		/	/	Ekziston plani detaj urbanistik. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2008, por nuk ka miratim te planit rregullues urbanistik.
12	Kolovica e re	JO		23.07.2009	/	/	/		Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2009, por nuk ka miratim te planit rregullues urbanistik.
13	Lakrishte	PO		29.03.2007	24.07.2007	12.07.2012	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda

									afatit ligjor.
14	Mati 1	PO	21.06.2005	/	03.08.2005	/	01.04.2010 14.07.2011		Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
15	Mati 2	JO		12.07.2012	/	/	/	/	Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2012, por nuk ka miratim të planit rregullues urbanistik.
16	Mati 3	PO	/	/	29.03.2007	/	/	29.03.2012	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar.
17	Medrese - Çameri	PO	/	16.07.2008	29.12.2011	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
18	Muhaxhirët	PO	/	22.11.2005	29.06.2010	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
19	Prishtina e re - Lindje	PO	/	12.05.2009	02.10.2013	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
20	Prishtina e re - Qendër	PO	/	12.05.2009	02.10.2013	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
21	Prishtina e re - Perëndim	PO	/	12.05.2009	02.10.2013	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
22	Qendra 1	PO	21.06.2005	/	03.08.2005	/	26.11.2008	26.11.2013	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar
23	Qendra 2	PO	19.08.2005	/	22.11.2005	/	/	22.11.2010	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar
24	Qendra Ulpiana	PO	/	05.04.2005	22.11.2005	/	/	22.11.2010	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar
25	Zona Historike e Qytetit dhe Qendra e Zejtareve	JO	/	27.12.2006	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1978. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2006, por nuk ka miratim të planit rregullues urbanistik.
26	Qyteza Pejton	PO	/	16.07.2008	06.01.2011	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
27	Sofalia	PO	/	29.03.2007	24.07.2007	12.07.2012	/	24.07.2012	Ka skaduar rishikimi i fundit/ nuk ka plan të ri të miratuar
28	Taslixhe	JO	/	23.07.2009	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1982. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2009, por nuk ka miratim të planit rregullues urbanistik.
29	Tophane	PO	19.08.2005	/	22.11.2005	/	24.07.2007 03.04.2008 27.08.2013	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
30	Ulpiana	JO	/	/	/	/	/	/	Rishikimi i fundit -plotësim i planit detaj në vitin 1975. Nuk është marrë vendim për rishikim të tij ose hartimin e planit rregullues urban.

31	Vellusha	JO	/	16.07.2008	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik. Është marrë vendim për hartim të planit në vitin 2008, por nuk ka miratim të planit rregullues urbanistik.
32	Vreshta	JO	/	/	/	12.03.2002	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1982. Ekziston vendimi për miratimin e rishikimit/ ndryshimit të pjesshëm në vitin 2002. Nuk është marrë vendim për rishikimin e tij apo hartimin e planit rregullues urbanistik.
33	Velania	JO	/	/	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1976. Nuk është marrë vendim për rishikim të tij.
34	Zona e Depove të Materialit Ndërtimor dhe Operativës Ndërtimore - Zejtare	JO	/	/	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1977. Nuk është marrë vendim për rishikim të tij.
35	Zona Ekonomike	PO	/	16.07.2008	31.05.2012	/	/	/	Plani Rregullues Urbanistik brenda afatit ligjor.
36	Zona Industriale e Qytetit	JO	/	/	/	/	/	/	Ekziston plani detaj urbanistik i vitit 1977. Nuk është marrë vendim për rishikim të tij.

*Të gjitha të dhënat e paraqitura mësipër janë punuar në bazë të dokumenteve të ofruara nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës, bazuar në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare, me të cilën janë kërkuar të gjitha planet rregulluese urbanistike dhe planet detaje në fuqi, si dhe vendimet relevante të ndërlidhura me këto plane.

** PRRU - Plane Rregulluese Urbanistike

Vërejtje:

- Në bazë të Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor (Ligji Nr. 04/L-174) Neni 17 pika 8: Komuna shqyrton dhe sipas nevojës e ndryshon Planin Rregullues të Hollësishëm çdo pesë (5) vite.
- Në bazë të ligjit të kaluar për Planifikim Hapësinor Ligji 2003/14, Neni 15.2: Secila Komunë do t'i shqyrtojë dhe, nëse është nevoja ndryshojë Planet Rregulluese Urbane!